



## KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

### PROCES VERBAL

**Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Qershor 2025**

**Data 26.06.2025 ora 14:00.**

**Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.**

#### **Rendi i dites:**

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.05.2025 dhe 05.06.2025, si dhe informacion për VKB-të e marra në këto mbledhje.
- 2.Projekt vendim për miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Znj.Edona Ndue Molla.
- 3.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2025.
- 4.Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027 dhe numrin e punonjesve të Bashkisë Vau Dejës”.
- 5.Projekt vendim për miratimin e PBA 2026-2028, faza e parë për Bashkinë Vau Dejës.
- 6.Raport i monitorimit për periudhën Janar-Prill 2025 dhe vetëvlerësimi për situatën e gjendjes financiare Janar-Prill 2025.
- 7.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes të shtetasit Pjetër Mirash Gjoni i dëmtuar nga zjarri me datë 16.05.2025, banorë i Bashkisë Vau Dejës.
- 8.Projekt vendim për miratimin e rinovimit të kontratës së qirasë me nr.1460 prot. datë 16.03.2022, lidhur me Bashkisë Vau Dejës dhe shoqërisë “ONE Albania sh.a”për sipërfaqen prej 150 m2 pjesë e pasurisë nr.663 Zk 2708 e llojit “Truall” në fshatin Mnelë Bashkia Vau Dejës.Fusha e përdorimit të pronës “ Për ushtrimin e veprimtarisë së antenave të transmetimit të telefonisë celulare të shoqërisë “ONE Albania sh.a”.
- 9.Projekt vendim për miratimin e subvencionit të qirasë dhe vlerën e përfitimit për znj.Matilda Terziu në programin e strehimit “ Subvencioni i qirasë në tregun e lirë”
- 10.Të ndryshme.

Grupe interesi nuk ka të pranishëm , votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes u zhvillua me datë 26.06.2025 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 20 këshilltarë, (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Neki Kapllanaj,Franga Kola, Frano Prenga, Ornella Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Rita



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Preçi, Rregjinë Shelqetja, Marin Dodaj, Gjon Marku, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri, Edona Molla). korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dities dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e dities.**Në këtë moment largohet nga mbledhja Z.Gjon Marku dhe në sallë mbesin 19 këshilltarë**, korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Z.Ermir Tahiri – këshilltarë,propozon: Propozoj që pika 8 e rendit të dities të mos shqyrtohet këtë mbledhje për arsye se kërkoj nga sektori i aseteve të na sjellë relacion me shkrim lidhur me zbatueshmërinë e kontratës që ka patur subjekti “ONE Albania sh.a” me Bashkinë Vau Dejës, kryesisht lidhur me pagesat e detyrimeve sepse në projekt vendimin e paraqitur nuk e kemi një informacion të tillë.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim propozimin e ngritur nga Z.Ermir Tahiri.

Votohet propozimi dhe 13 këshilltarë votuan pro heqjes nga rendi i dities( Franga Kola,Frano Prenga,Neki Kapllanaj, Meliha Zyberaj,Rita Preçi,Leonora Prenga, Ornella Lleshi, Ermir Tahiri,Albina Livadhi, Mirela Vasija,Rregjinë Shelqetja, Besmir Kapaj, Vjollcë Zagani).Këshilltarët e tjerë nuk moren pjesë në votim.**Miratohet heqja nga rendi i dities pika 8.**

**Rendi i dities miratohet pa piken 8-të.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të dities:**

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.05.2025dhe 05.06.2025 si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 26.05.2025 dhe datës 05.06.2025 nga Z.Ervis Shimaj.Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij(Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Neki Kapllanaj,Franga Kola, Frano Prenga, Ornella Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Rita Preçi, Rregjinë Shelqetja, Marin Dodaj, Gjon Marku, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri, )Znj.Edona Molla nuk ka të drejtë vote pa u mandatuar.

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të dities:**

Projekt vendim për miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Znj.Edona Ndue Molla.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z.Ervis Shimaj sqaron për këshilltarët se KQZ Tiranë ka sjellë vendimin për plotesimin e vakancës së krijuar nga Znj.Kristjana Kovaçi me Znj.Edona Molla dhe komisioni i mandateve të këshillit Bashkiak Vau Dejës, propozon miratimin e mandatimit të Znj,Edona Molla.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për pyetje apo diskutime.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin.**Miratohet me 18 vota Pro, zero kundër, zero abstenim.V.O-Znj.Edona Molla nuk ka të drejtë ligjore të votojë për mandatin e sajë dhe për rrjedhojë nuk mori pjesë në votim.**Këshilltarët që votuan Pro: (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Neki Kapllanaj,Franga Kola, Frano Prenga, Ornela Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Rita Preçi, Rregjinë Shelqetja, Marin Dodaj, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2025

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se projekt vendimi është hartuar bazuar ne ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

Ajo shprehet se bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Maj 2025 , të përfitojnë familje 137, me 450.753 lekë, me 5.98% e fondit total.Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Maj 2025 janë shpallur fitues, 984 familje, me fond 7.543.969 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 452.638 lekë.

Z.Ervis Shimaj spjegon se komisioni i K.Bashkiak ka propozuar miratimin e projekt vendimit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

**Miratohet me 19 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.** Këshilltarët që votuan Pro piken e tretë të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Neki Kapllanaj,Franga Kola, Frano Prenga, Ornela Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Rita Preçi, Rregjinë Shelqetja, Marin Dodaj, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri, Edona Molla).



**Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:**

Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027 dhe numrin e punonjesve të Bashkisë Vau Dejës”.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Elsa Tanushi pergjegjese e zyres financë buxhetit Bashkia Vau Dejës e cila relatoi se ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vkb nr.84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027 dhe numrin e punonjesve të Bashkisë Vau Dejës” dhe Shprehjes Ligjshmerisë nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025, duke plotësuar nevojat e Bashkisë Vau Dejës.Znj Elsa Tanushi spjeron se nga ky ndryshim nuk preken projektet prioritare që janë miratuar për vitin 2025. Duke u nisur nga shkresa Nr 3146 Prot datë 05.06.2025 e Drejtorisë së Menaxhimit të Pyjeve Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit drejtuar Sektorit të Financës me lëndë “Kërkesë për hartim plane Mbarështimi të Pyjeve dhe Kullotave" jemi angazhuar për të vënë në dispozicion vlerën e kërkuar për realizimin e projektit duke bërë rishpërndarje buxheti ndërmjet programeve buxhetore.

Rishpërndarja e buxhetit do të bëhet sipas tabelës nr 1 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi. Kemi prekur zëra buxheti të investimeve që nuk janë pjesë e projekteve prioritare për vitet 2025-2027 që i përkasin programit 04130, gjithashtu është bërë ndryshim emertim projekti për zërin "Plani i menxhimit të pyjeve" me kod produkti 1570379 në zërin "Hartim plane mbarështimi të pyjeve dhe kullotave" që i përket të njëjtit kod produkti, në zbatim të nenit 100 Rishpërndarja e fondeve buxhetore të njesise së veteqeverisjes vendore, ligji nr. 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", udhëzimit Plotësues Nr. 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit 2025"; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Nr. 84 datë 23.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027, numrin e punonjesve për Bashkinë Vau Dejës" miratuar me shprehje ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me shkresë nr. 860/1 prot datë 06.01.2025.

Gjithashtu nisur nga shkresa Nr 3421 Prot datë 19.06.2025 e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Kadastrës dhe Investimeve Publike, Sektori i Investimeve publike drejtuar Sektorit të Financës me lëndë “Kërkesë për rishikim Buxheti " jemi angazhuar për të vënë në dispozicion vlerën e kërkuar për realizimin e projekteve duke bërë rishpërndarje buxheti ndërmjet programeve buxhetore në rritje të programit 04520 Rrjeti rrugor rural.

Në kuadër të listës së projekteve prioritare të miratuara me VKB nr 84 datë 23.12.2024 kemi bërë rishpërndarje buxheti për të bërë të mundur disponimin e fondeve të nevojshme për realizimin e këtyre projekteve që do të shtrihen në vitet 2025-2027.

Rishpërndarja është bërë nga zëra buxheti të trashëguara në buxhetin 2025, që nuk kanë qënë pjesë e projekteve prioritare të miratuara për vitin 2025. Per vitin 2026 dhe vitin 2027 është bere rishpërndarje nga zeri i projektit "Reabilitim Perroi i Glines+Mbikqyrje+kolaudim", i cili per shkak te mungeses se bashkefinancimit nga ana e Ministrise se Mbrojtjes, (qe ishte menduar ne momentin e parashikimit ne buxhet) eshte per momentin i parealizueshem si projekt me vetem fondet e bashkise.

Z.Ervis Shimaj spjeron se komisioni i K.Bashkiak ka propozuar miratimin e projekt vendimit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

**Miratohet me 19 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.** Këshilltarët që votuan Pro piken e katërt të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Neki Kapllanaj, Franga Kola, Frano Prenga, Ornella Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Rita Preçi, Rregjinë Shelqetja, Marin Dodaj, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri, Edona Molla).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e PBA 2026-2028, faza e parë për Bashkinë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj spjegon për këshilltarët se për këtë pikë të rendit të ditës është bërë dëgjese publike me datë 25.06.2025 dhe fton për të relatuar Znj.Elsa Tanushi pergjegjese e zyres financë buxhetit Bashkia Vau Dejës e cila relatoi se ky projekt vendim paraqitet për shqyrtim pasi kemi miratuar tavanet buxhetore që në muajin Mars 2025 dhe tani jemi në fazen e parë të pregaditjes së PBA 2026-2028.Për hartimin e këtij projekt vendimi është zbatuar baza ligjore.

Të ardhurat e veta të Bashkisë parashikohen ne vlerat si me poshte

| Nr     | Vitet                                | 2026      | 2027      | 2027      |
|--------|--------------------------------------|-----------|-----------|-----------|
| 1      | Transferta e Pakushtëzuar            | 383,754   | 395,082   | 406,131   |
| 2      | Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale | 146,418   | 146,736   | 147,059   |
| 3      | Transferta e Kushtëzuar              | 402,143   | 413,403   | 414,603   |
| 4      | Të Ardhurat                          | 177,000   | 177,610   | 178,064   |
| TOTALI |                                      | 1,109,315 | 1,132,830 | 1,145,856 |

Buxheti total per periudhen 2026-2028 do të bëhet sipas tabelës se meposhtme:

| Nr     | Vitet                                | 2026      | 2027      | 2027      |
|--------|--------------------------------------|-----------|-----------|-----------|
| 1      | Transferta e Pakushtëzuar            | 383,754   | 395,082   | 406,131   |
| 2      | Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale | 146,418   | 146,736   | 147,059   |
| 3      | Transferta e Kushtëzuar              | 402,143   | 413,403   | 414,603   |
| 4      | Të Ardhurat                          | 177,000   | 177,610   | 178,064   |
| TOTALI |                                      | 1,109,315 | 1,132,830 | 1,145,856 |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Hartimi i buxhetit të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 do të kalojë edhe në fazë të tjerë ku kryesisht do merren në konsideratë edhe propozimet që do dalin në konsultime publike nga grupet e interesit.

Z. Ervis Shimaj shpjegon se komisioni i K. Bashkiak ka propozuar miratimin e projekt vendimit.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

**Miratohet me 19 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.** Këshilltarët që votuan Pro piken e pestë të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Neki Kapllanaj, Franga Kola, Frano Prenga, Ornela Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Rita Preçi, Rregjinë Shelqetja, Marin Dodaj, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri, Edona Molla).

**Z. Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:**

Raport i monitorimit për periudhën Janar-Prill 2025 dhe vetëvlerësimi për situatën e gjendjes financiare Janar-Prill 2025

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj. Elsa Tanushi përgjegjëse e zyrës financë buxhetit Bashkia Vau Dejës e cila relatoi se për periudhën Janar-Prill 2025, është trendi në rritje i të ardhurave, por lind e nevojshme që të shtohet perkushtimi që të kemi rritje edhe me të mëdha sepse kjo rritje sjell edhe rritjen e investimeve në sektor të ndryshëm. Peshën specifike të të ardhurave e ka Nj. A Bushat me 60 % të totalit, Nj. A Vau Dejës me 30 % dhe njesit e tjera mbulojnë 10 % të totalit.

Shpenzimet për periudhën Janar-Prill 2025, janë realizuar në masën 100%. Situata ekonomiko financiare e bashkisë për periudhën Janar-Prill 2025 është e kënaqshme me trend rritjeje.

Z. Ervis Shimaj shpjegon se komisioni i K. Bashkiak ka propozuar miratimin e raportit të monitorimit.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim raportin e monitorimit për periudhën Janar-Prill 2025 dhe vetëvlerësimi për situatën e gjendjes financiare Janar-Prill 2025

**Miratohet me 19 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.** Këshilltarët që votuan Pro piken e gjashtë të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Neki Kapllanaj, Franga Kola, Frano Prenga, Ornela Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Rita Preçi, Rregjinë Shelqetja, Marin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Dodaj, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri, Edona Molla).

### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes të shtetasit Pjetër Mirash Gjoni i dëmtuar nga zjarri me datë 16.05.2025, banorë i Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Valjeta Nikaj-përgjegjëse e zyres emergjencave civile, bashkia Vau Dejës, e cila relatton për këshilltarët se në bazë të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 41, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pika 3, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banasave për vitin 2016" si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve," Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga zjarri i rënë në banesën e shtetasit Pjetër Mirash Gjoni me dt. 16.05.2025 që është banorë i fshatit Fshat i Ri te Njesise Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës, i propozon Keshillit Bashkiak që të miratojë kërkesën për ndihmë. Keshilltarëve u kërkohet të:

1. Të miratojnë kërkesën e Bashkisë Vau Dejës për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së z.Pjetër Mirash Gjoni (4 anëtarë në familje), në vlerën 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë për dëmtimin plotësisht të banesës së tij nga zjarri.

2. Të miratojnë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Vau Dejës, për familjen e z.Pjetër Mirash Gjoni në vlerën totale të dëmit 4.841.703 (Katërmilion e tetëqind e katërdhjetë e një mijë e shtatëqind e tre) lekë.

3. Të miratojnë dhënien e kompensimit sipas proces verbalit të vlerësimit i hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në masën 50% të vlerës totale në shumën 2.420.851.5 (dymilion e katerqind e njezet mijë e tetëqind e e pesëdhjetë e një pikë pesë) lekë.

Burimi i financimit do të jetë pjesërisht fondi i kushtëzuar i vitit 2025 sipas shkresës nr.492/1 dt.25.02.2025 e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.991 prot dt.27.02.2025 "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për programin e Mbrojtjes Civile" në masën 1.500.000 (njëmilion e pesëqind mijë) leke ndërsa pjesa e mbetur prej 1.000.851.5 (njëmilion e tetëqind e pesëdhjetë e një pike pesë) është fondi i Bashkisë i planifikuar për programin e Mbrojtje Civile miratuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.84 dt.23.12.2024 "Mbi mjetimin e buxhetit 2025" konfirmuar nga Prefektura Shkodër me shkresën 860/1 dt.06.01.2025.

Z.Ervis Shimaj spjegon se komisioni i emergjencave civile i K.Bashkiak ka propozuar miratimin e projekt vendimit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.



Z.Ervis Shimaj e hedh në projekt vendimin:

**Miratohet me 19 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.** Këshilltarët që votuan Pro piken e shtatë të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Neki Kapllanaj, Franga Kola, Frano Prenga, Ornela Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Rita Preçi, Rregjinë Shelqetja, Marin Dodaj, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri, Edona Molla).

Pika tetë është hequr nga rendi i ditës për tu shqyrtuar këtë mbledhje.

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e nëntë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e subvencionit të qirasë dhe vleren e përfitimit për znj.Matilda Terziu në programin e strehimit " Subvencioni i qirasë në tregun e lirë"

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Edmond Gjeçaj-specialist pranë zyres së strehimit social, Bashkia Vau Dejës, i cili spjegoi se për hartimin e projekt vendimit është zbatuar me korrektesi baza ligjore dhe se komisioni i Strehimit i ngritur me VKB Nr.21 me 26.03.2025 "Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit", realizoi mbledhjen në datën 12.06.2025. Ku u be shqyrtimi i dokumentacionit të plotë dhe kontrataes së qirasë noteriale për banorën Matilda Terziu.

Nga vlersimi social ekonomik vërehet se kjo banore është e pastreh në proces divorci me një femijë 2 vjeç e papunësuar aktualisht, të ardhura të pamjaftueshme për të perballuar një shtëpi me qira, si dhe shpenzimet jetike.

Komisioni i strehimit e shikon të arsyeshme për të asisituuar si përfitues të programit të strehimit subvencioni i qirasë në tregun e lire, znj.Matilda Terziu.

Z.Ervis Shimaj spjegon se komisioni i K.Bashkiak ka propozuar miratimin e projekt vendimit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në projekt vendimin:

**Miratohet me 19 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.** Këshilltarët që votuan Pro piken e nëntë të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Meliha Zyberaj, Neki Kapllanaj, Franga Kola, Frano Prenga, Ornela Lleshi, Majlinda Ndreca, Leonora Prenga, Rita Preçi, Rregjinë Shelqetja, Marin Dodaj, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri, Edona Molla).

Pika 10 Të ndryshme; Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Frano Prenga propozon: Ti rritet paga në vleren 250.000 lek në muaj Kryetarit të Bashkisë dhe i propozoj zyres perkatëse që të pregadisë projekt vendimin dhe ta sjellë për shqyrtim pranë Këshillit Bashkiak muajin e ardhshëm.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbledhjen e radhës e datës 26.06.2025 deklarohet e mbyllur nga kryetari Këshillit pasi nuk kishte pyetje apo diskutime tjera.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian ÇELEPIJA



Këshilltarët:

- |                              |                         |
|------------------------------|-------------------------|
| 1. <u>Envis Shimag</u>       | 16. <u>Mark Bish</u>    |
| 2. <u>Melike Zheqir</u>      | 17. <u>Souye Zogaj</u>  |
| 3. <u>Meli Uqshani</u>       | 18. <u>Beama Kogaj</u>  |
| 4. <u>Enxhpa Dalo</u>        | 19. <u>Ermin Tohir</u>  |
| 5. <u>Enxho Bregu</u>        | 20. <u>Edona Mollaj</u> |
| 6. <u>Ornela Lleshi</u>      | 21. _____               |
| 7. <u>Mejlinda Vekes</u>     | 22. _____               |
| 8. <u>Leonora Prenpe</u>     | 23. _____               |
| 9. <u>Rita Bregi</u>         | 24. _____               |
| 10. <u>Prezime Shkëlqeti</u> | 25. _____               |
| 11. <u>Marin Beshaj</u>      | 26. _____               |
| 12. <u>Gjon Marku</u>        | 27. _____               |
| 13. <u>Kirela Vasija</u>     | 28. _____               |
| 14. <u>Allena Sivadihi</u>   | 29. _____               |
| 15. <u>Vjollcë Zogaj</u>     | 30. _____               |
|                              | 31. _____               |